



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 42

Tiranë – E enjte, 19 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.217, datë 12.3.2020	Për një shtesë në vendimin nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 3071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.219, datë 12.3.2020	Për miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien, për programin “Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe tuberkulozit në grupet kryesore të popullatës”, miratuar me vendimin nr.126, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave..... 3071
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.220, datë 12.3.2020	Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe të kritereve të përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit..... 3077
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.221, datë 12.3.2020	Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil..... 3078
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 27.2.2020	Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit” 3078
Kërkesë e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2685, datë 11.3.2020	Për shpronësim, për interes publik të pasurive së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit të ri elektrik 20 kV, Fideri F2 dhe Fideri F4, në Fushë Krujë..... 3084



VENDIM
Nr.217, datë 12.3.2020

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.718,
DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”, shtohet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PËRDITËSIMI NË LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS
REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË
SIGURIMIT TË OKB-SË
 (“LISTA E OKB-së”)**

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANI-ZATAT ISIL (DA’ESH) DHE AL-QAIDA”:

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da’esh) dhe AL-Qaida”:

1: AMADOU 2: KOUFA

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr.219, datë 12.3.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT, NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, NË EMËR TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT GLOBAL
PËR TË LUFTUAR SIDA-N,
TUBERKULOZIN DHE MALARIEN, PËR
PROGRAMIN “PËRSHKALLËZIMI DHE
SIGURIMI I QËNDRUESHMËRISË SË
PËRGJIGJES KOMBËTARE NDAJ
HIV/SIDA-S DHE TUBERKULOZIT NË
GRUPET KRYESORE TË POPULLATËS”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.126,
DATË 13.2.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarinë, për programin “Përkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe Tuberkulozit në grupet kryesore të popullatës”, miratuar me vendimin nr.126, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Fondi Global**Versioni ekzekutiv****Konfirmim Granti**

1. Ky **Konfirmim Granti** është hartuar dhe nënshkruar nga **Fondi Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarinë (“Fondi Global” dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë (“Përfutuesi kryesor”)**, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (**“Marrësi i Grantit”**), në datën e nënshkrimit të fundit si më

poshtë dhe hyn në fuqi në datën e fillimit të Periudhës së Zbatimit (përcaktuar më poshtë), në përputhje me Marrëveshjen Kuadër, të datës 27 korrik 2016, e ndryshuar dhe e plotësuar herë pas here (**“Marrëveshja Kuadër”**) ndërmjet Fondit Global dhe Marrësit të Grantit, për të zbatuar Programin e përcaktuar si më poshtë.

2. **Marrëveshje e Vetme.** Ky Konfirmim Granti, së bashku me Përshkrimin e Integruar të Grantit, e bashkëlidhur si skeduli 1, përcakton dispozitat (duke përfshirë, pa kufizim, politikat, përfaqësimet, kontratat, veprimtaritë e programit, buxhetin e programit, kuadrin e performancës, dhe marrëveshjet e lidhura zbatuese) të zbatueshme për Programin, dhe është pjesë e Marrëveshjes së Grantit. Çdo term i përdorur me shkronjë të madhe, por i pa përkufizuar në këtë Konfirmim Granti, ka kuptimin siç është përcaktuar në Marrëveshjen Kuadër (përfshirë edhe në Rregulloren e Grantit të Fondit Global (2014), në dispozicion në faqen e internetit <http://theglobalfund.org/GrantRegulations>). Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet këtij Konfirmimi Granti dhe Marrëveshjes Kuadër (përfshirë edhe Rregulloren e Grantit të Fondit Global (2014)), dispozitat e këtij Konfirmim Granti do të rregullohen përveç nëse parashikohet shprehimisht ndryshe në Marrëveshjen Kuadër.

3. **Informacion Granti.** Fondi Global dhe Marrësi i Grantit me anë të kësaj konfirmojmë më poshtë:

3.1.	Vendi ose Rajoni pritës:	Republika e Shqipërisë
3.2.	Komponenti i sëmundjes:	HIV/AIDS, Tuberkulozi
3.3.	Titulli i Programit:	Përkallëzimi dhe Sigurimi i Qëndrueshmërisë së Përgjigjes Kombëtare ndaj HIV/SIDA-s
3.4.	Emri i Grantit:	ALB-C-MOH
3.5.	Numri i Grantit:	1854
3.6.	Fondet e Grantit:	Deri në shumën e 1,638,134.00 Dollar ose shumën e tij të barazvlefshme në ndonjë monedhë tjetër
3.7.	Periudha e Zbatimit:	Nga 1 janar 2020 deri 31 dhjetor 2022 (përfshirë)
3.8.	Marrësi Kryesor:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtja Sociale e Republikës së Shqipërisë Rruga e Kavajës Nr. 1001, Tiranë Republika e Shqipërisë Në vëmendje të: Znj. Ogerta Manastirliu Ministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e



		Republikës së Shqipërisë Telefon: +35542376178 E-mail: ogerta.manastirliu@shendetesia.gov.al
3.9.	Viti Tatimor:	1 janar deri 31 dhjetor
3.10.	Agjenti i Fondit Vendor:	Pricewaterhouse Coopers, Shqipëri Blvd. Dëshmorët e Kombit Kullat Binjake Kulla 1, Kati 10-të Tiranë, Republika e Shqipërisë Në vëmendje të: Z. Jonid Lamllari Menaxher i Lartë, Sigurimi Telefon: +41 587929100 E-mail: jonid.lamllari@al.pwc.com
3.11.	Kontakti i Fondit Global:	Fondi Global për të luftuar SID-ën, Turbekulozin dhe Malarien, Kampusi i Shëndetit Global, Chemin du Pommier 40 1218 Grand-Saconnex, Gjenevë, Zvicër Në vëmendje të: Z. Dumitru Laticevski Menaxher Rajonal, EECA Divizioni i Menaxhimit të Grantit Telefon: +41 58 791 1700 Faksimile: +41 44 580 6820 E-mail: jonid.lamllari@al.pwc.com

4. **Politikat:** Marrësi i Grantit duhet dhe siguron që Përfituesi kryesor të ndërmarrë hapat e përshtatshëm dhe të nevojshëm për të qenë në pajtim me (1) Udhëzimet e Fondit Global për Buxhetimin e Grantit (2017, të ndryshuara herë pas herë), (2) Udhëzuesin për Produktet Shëndetësore, i ndryshuar (2016, i ndryshuar herë pas herë) dhe (3) ndonjë politikë, procedurë, rregullore dhe udhëzime tjera, të cilat Fondi Global mund t'i komunikojë me shkrim me Marrësin e Grantit dhe Përfituesin kryesor, herë pas here.

5. **Përfaqësime.** Përveç përfaqësimeve të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër (përfshirë Rregulloren e Grantit të Fondit Global (2014)), Përfituesi kryesor përfaqëson se Përfituesi kryesor ka të gjithë kompetencën e nevojshme, është i autorizuar siç duhet nga, ose ka marrë të gjitha pëlqimet e nevojshme, miratimet dhe autorizimet për të zbatuar dhe ofruar këtë Konfirmim Granti dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet në emër të Marrësit të Grantit, sipas këtij Konfirmimi Granti. Zbatimi, ofrimi dhe përmbushja e këtij Konfirmimi Granti nga Përfituesi Kryesor në emër

të Marrësit të Grantit nuk është në shkelje apo bie ndesh me ndonjë ligj të zbatueshëm, me ndonjë nga dispozitat e dokumenteve kushtetuese të Marrësit të Grantit dhe Përfituesit Kryesor, me ndonjë urdhër apo gjykim të ndonjë gjykate apo të ndonjë autoriteti kompetent apo me ndonjë kufizim kontraktues të detyrueshëm për ose që ndikon tek Marrësi i Grantit apo Përfituesi Kryesor.

6. **Kontratat.** Fondi Global dhe Marrësi i Grantit më tej bie dakord se:

6.1. Në përputhje me Qëndrueshmërinë, Tranzicionin e Fondit Global dhe Politikën e Bashkë Financimit (GF/B35/04) ("Politika STC"), Marrësi duhet të:

6.1.1. në mënyrë progresive rrisin shpenzimet e qeverisë mbi shëndetin për të përmbushur qëllimet kombëtare të mbulimit të shëndetit universale; dhe rrit bashkëfinancimin e programeve të mbështetura të Fondit Global, fokusuar në mënyrë progresive marrjen e kostove kryesore të planeve të sëmundjeve kombëtare (Kërkesat Themelore për Bashkë-Financim). Angazhimi dhe disbursimi i



Fondeve të Grantit i nënshtrohen pëlqimit të Fondit Global, me pajtueshmërinë e Marrësit të Grantit me Kërkesat Thelbësore të Bashkëfinancimit. Fondi Global mund të reduktojë Fondet e Grantit gjatë Periudhës së Zbatimit, në bazë të mospajtueshmërisë me Kërkesat Thelbësore të Bashkëfinancimit;

6.1.2. përputhet me kërkesat për të hyrë në stimulin e bashkë-financimit siç përcaktohet në Politikën STC (**“Kërkesat e stimulimit për bashkë-financim”**). Angazhimi dhe disbursimi i 25% i Marrësit të Grantit I HIV dhe Alokimi i TB-së prej 1, 638,134 për periudhën e alokimit 2017-2019 (për shmangien e dyshimit, periudhën e zbatimit të grantit pritët të mbulojë periudhën 2020-2022), e cila është e barabartë me 409, 534 dollarë (**“Stimulimi i Bashkë-financimit”**) i nënshtrohet kënaqësisë së Fondit Global me Marrësin e Grantit në pajtim me Kërkesat e Stimulimit për Bashkë-financimit. Fondi Global mund të reduktojë Stimulin e Bashkë-financimit gjatë Periudhës së Zbatimit, ose nga alokimi i mëvonshëm, në përpjesëtim me mosrespektimin e kërkesave të stimulimit të bashkë-financimit, dhe

6.1.3. të sigurojë për kostot e burimit njerëzor të organizatave joqeveritare dhe kostot për prokurimin e konsumueshme në 2021-2023, për të siguruar mbulim të plotë të shërbimeve të parandalimit të HIV të organizatave të tilla joqeveritare për punëtorët e seksit, burrat që bëjnë seks me burra dhe njerëzit që injektojnë drogë. Bashkë-financimi i Marrësit të Grantit për shërbimet e parandalimit të HIV duhet të jenë në përputhje me planin e tranzicionit të përcaktuar në Buxhet dhe qëllimet në Kuadrin e Performancës.

6.2. Në lidhje me Seksionin 7.6 (*E Drejta e Aksesit*) të Rregullores së Grantit të Fondit Global (2014), kuptohet dhe është rënë dakord se (1) Fondi Global mund të mbledh ose të kërkojë mbledhjen e të dhënave dhe është e mundur që këto të dhëna të përmbajnë informacion, i cili mund të përdoret për të identifikuar një person apo njerëz dhe (2) Përfituesi Kryesor në emër të Marrësit të Grantit ka ndërmarrë apo ka shkaktuar që duhet të ndërmerren para mbledhjes dhe pas kësaj çdo gjë që është e nevojshme sipas ligjeve të zbatueshme të Republikës së Shqipërisë për të siguruar që informacion i tillë mund të transferohet tek Fondi Global për qëllim të tillë sipas kërkesës.

6.3. Tranzicioni ndërmjet Granteve:

6.3.1. Buxheti i Programit në Përshkrimin e Grantit të Integruar të bashkëngjitur këtu si Skeduli 1 pasqyron shumën totale të Fondit Global të vihet në dispozicion të Programit. Buxheti i Programit mund të financohet pjesërisht nga fondet e grantit të disbursuara Grante në bazë të një Marrëveshjeje të Grantit të mëparshëm, për të cilën Fondi Global e ka miratuar për t'u përdorur për Programin sipas Marrëveshjes aktuale të Grantit (**“Fondet e Granteve të Disbursuara më Parë”**), si dhe Fondet shtesë të Grantit deri në shumën e përcaktuar në Seksionin 3.6 të Konfirmimit Grant. Ku Fondi Global ka miratuar përdorimin e Fondeve të Grantit të Disbursuara më parë, Fondi Global mund të reduktojë shumën e Fondeve Globale të përcaktuara në Seksionin 3.6 të Konfirmimit Grant nga shuma e çdo Fondi të Grantit të Disbursuara më parë, dhe përkufizimi i Fondeve të Grantit të përcaktuar në Seksionin 2.2 (*Përkufizimet*) e Rregulloreve të Fondeve Globale (2014) do të përfshijë ndonjë Fond të Grantit të Disbursuara më parë.

6.3.2. Të gjitha pasuritë jo-monetare të mbetura sipas ndonjë Marrëveshjeje të Mëparshme të Grantit që nga data e fillimit të periudhës së zbatimit, duhet të llogariten plotësisht dhe të dokumentohen siç duhet (**“Aktivet e Mëparshme të Programit”**). Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Fondin Global, përkufizimi i Aktiveve të programit të përcaktuar në Seksionin 2.2 (*Përkufizimet*) e rregulloreve të Fondeve Globale (2014) do të përfshijnë ndonjë Aktiv të mëparshëm të Programit.

6.3.3. Për shmangien e dyshimit, përveç siç përcaktohet në mënyrë të qartë këtu, asgjë në Marrëveshjen e Grantit të çastit nuk do të ndikojë në detyrimet e Grantit dhe/ose Përfituesit Kryesor, sipas çdo Marrëveshjeje Grantshe të mëparshme të Grantit, përfshirë, por pa u kufizuar në, ato që kanë të bëjnë me raportimet financiare dhe raporte të tjera.

6.4. Palët pranojnë se Fondi Global ka ruajtur shërbimet e auditorit të jashtëm rajonal (**“Audituesi”**) për të kryer auditimet e pavarura vjetore të Programit, të financuara me Fondet e Grantit, në përputhje me nenin 7 të Rregulloreve të Fondit Global (2014). Përfituesi kryesor në emër të Marrësit të Grantit me anë të kësaj bie dakord:



6.4.1. për përdorimin e Fondeve të Granteve, disbursuar direkt nga Fondi Global për Auditorin, për auditimin e pavarur vjetor të programit;

6.4.2. me Kushtet e Referencës të Auditorit; dhe

6.4.3. pa u kufizuar me Seksionin 7.5 (*Auditi nga Fondi Global*) i Rregullores së Fondit Global të Grantit (2014), për të bashkëpunuar plotësisht dhe punuar me Auditorin, përfshirë duke siguruar të gjitha dokumentet e kërkuara dhe informacionin për Auditorin dhe /ose Fondin Global;

6.5. Jo më vonë se 31 mars 2020, Përfituesi Kryesor do të paraqesë për Fondin Global, në formë dhe substancë të kënaqshme për Fondin Global, Planet Strategjike Kombëtare të rishikuara dhe të kushtuar dhe Planet Kombëtare M&E që mbulojnë periudhën 2020-2024 për programet HIV dhe TB, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë. Plani Kombëtar M&E pritët të përfshijë elementët e mëposhtëm: (a): fleta e përkufizimeve për të gjithë treguesit kombëtarë, përfshirë ato të Kuadrit të Performancës së Fondit Global; (b) mbledhja rutinë e të dhënave dhe administrimi i të dhënave; (c) sigurimi i cilësisë së të dhënave (përfshirë një plan mbikëqyrës); (d) planet për rishikime, vlerësime dhe vëzhgime të programit, (e) monitorimi dhe koordinimi i vlerësimit; (f) një plan për ndërtimin e kapaciteteve; dhe (g) një buxhet dhe plan pune.

6.6. Jo më vonë se 31 maj 2020, Përfituesi Kryesor do të kryejë rishikimet e thella të objektivave të Kuadrit të Performancës dhe Buxhetit bazuar në Planet Strategjike Kombëtare të rishikuara, Plani M&E dhe rezultatet e IBBS dhe vlerësimeve të madhësive të reja për MSM, SW dhe PWID.

6.7. Para përdorimit të Fondeve të Grantit për të financuar prokurimin e testeve të ngarkesës virale, testet ADN, testet CD4 dhe metadon, Përfituesi Kryesor do të dorëzojë tek Fondit Global konfirmimin me shkrim i vlerësimit të çmimit, dhe sasive të prokurimit nga Marrësi i Grantit të mbështetur nga dispozita e Trajtimit Kombëtar të HIV dhe Protokollat Diagnostikuese. Marrësi do të riallokojë burimet e tij të veta për të

siguruar disponueshmërinë për mbulim të plotë të trajtimit të HIV dhe nevojat diagnostikuese në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me rekomandimet OBSH për mbulimin e pacientëve të specifikuar në Kuadrin e Performancës.

[Faqja e nënshkrimi vijon]

NË DËSHMI TË KËSAJ, Fondi Global dhe Përfituesi kryesor kanë bërë që ky Konfirmim Granti të zbatohet dhe të ofrohet nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar siç duhet, në datën përkatëse të nënshkrimit më poshtë.

Fondi Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien

Nga: _____

Emri: Mark Edington

Titulli: Kreu, Divizioni i Menaxhimit të Granteve
Datë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë

në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Nga: _____

Emri: Ogerta Manastirliu

Titulli: Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Datë:

Pranuar Nga:

Emri: Ogerta Manastirliu

Titulli: Kryetari i Mekanizmit Koordinues të Vënit për Republikën e Shqipërisë.

Datë:

Nga:

Emri: Liljana Dango

Titulli: Përfaqësuese e Shoqërisë Civile
Mekanizmit Koordinues të Vënit
për Republikën e Shqipërisë
Datë:



SKEDULI 1 PËRSHKRIMI I INTEGRUAR I GRANTIT

Shteti:	Republika e Shqipërisë
Titulli i programit:	Përkallëzimi dhe Sigurimi i Qëndrueshmërisë së Përgjigjes Kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe TB-së në grupet kryesore të popullatës
Emri i Grantit:	ALB-C-MOH
Numri i Grantit:	1433
Sëmundja:	HIV/SIDA dhe Tuberkulozi
Përfutuesi kryesor:	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë

A. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

1. Historiku dhe Arsyetimi për Programin

Republika e Shqipërisë është një vend me të ardhura të mesme të larta me një popullsi prej 2.9 milion me ngarkesë të ulët të HIV-it dhe TB. Fondi Global aktualisht financoi një grant TB/HIV në Shqipëri, Përfutuesi kryesor i të cilit është Njësia e Menaxhimit të Projektit (“PMU”) themeluar si një subjekt ligjor për zbatimin e grantit, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë (“MoHSP”). Përbërësi TB e grantit është fokusuar në diagnozën e pacientëve dhe lidhja e diagnozës me trajtimin, si dhe mbi krijimin e kujdesit MDR-TB në Shqipëri. Komponenti HIV është fokusuar mbi ndalimin HIV/SIDA në popullatat kryesore dhe duke lidhur pacientët me HIV pozitiv për t'u kujdesur.

Shkalla e përgjithshme e vlerësuar e incidencës së TB është e ulët në Shqipëri, në 2017 arriti në 20/100.000, por para vitit 2007 ajo ishte duke ngratur ndërmjet 16 deri 19/100.000. Shkalla e vdekshmërisë nga TB është shumë e ulët -0.29/100.000 dhe është ulur pothuajse dyfish në krahasim me 2007-ën (nga 0.52/100.000). Mbulimi i trajtimit është e barabartë me 87%.

Në 2018, janë raportuar 440 raste të reja dhe të rikthimit të Tuberkulozit, prej të cilës 96% ishin raste të reja dhe 4% ishin rikthim raporti Mashkull në femër ishte 3:1. Shkalla e suksesit të trajtimit ishte 87%. Nga 440 rastet e TB të zbuluara në 2018, mbizotërimi i rezistencës së shumë ilaçeve u vlerësua në 0.8% Numri i njerëzve me të dyja Tuberkuloz dhe HIV nuk është e rëndësishëm, me tetë raste të reja në 2018; por, vetëm 49% e pacientëve me

Tuberkuloz ishin testuar për HIV. Duhet të theksohet se bashkë-infeksioni me TB-HIV ngadalë po rritet.

Shqipëria vazhdon të ketë një epidemi të ulët të prevalencës së HIV. Në 2017, incidenca e HIV ishte vlerësuar me 0.03%, numri i vlerësuar i PHLV ishte 1,400. Në vitet e fundit,

numri i rasteve të reja HIV ka ardhur duke u rritur: ndërmjet 2008 dhe 2018 numri vjetor i diagnozave të HIV-it është më shumë se dyfish nga 49 raste (2008) deri 127 raste në 2016, dhe 102 raste të reja në 2018. Deri në fund të Dhjetorit 2018, totali 1,205 i rasteve me HIV ishin raportuar në Shqipëri. Në 2018, rreth 73% e diagnozave të HIV ishin bërë në fazën e fundit të infeksionit HIV, me CD4 numëron më pak se 350, prej të cilëve pothuajse gjysma 47.1% paraqitën një numër CD4 më pak se 200. Nga fundi i vitit 2018, 581 Njerëzit që jetonin me HIV ishin në trajtimin Antiretroviral (ART).

Ky grant tranzicioni po synon të përgatisë programet e HIV dhe TB në Shqipëri për të mbështetur arritjet dhe për të rritur shkallën e diagnostikimit dhe trajtimit të TB dhe HIV pa burimet e Fondit Global. Fushat kryesore të tranzicionit për tu adresuar janë funksioni kombëtar i prokurimit për programet HIV dhe TB dhe një mekanizëm i qëndrueshëm financimi për ndërhyrjen parandaluese të HIV dhe TB të zbatuar nga shoqëria civile.

2. Qëllimet, strategjitë dhe veprimtaritë

Qëllimi: Për të siguruar se Shqipëria mbetet një vend me mbizotërim të ulët për Tuberkuloz dhe HIV.

Objektivat:

1. Për të siguruar një qasje të barabartë në parandalimin, trajtimin, kujdesin dhe përkrahjen



e Tuberkulozit dhe HIV me përqendrim të popullatat kryesore të prekura (MSM, PWID, SW, PLWHA dhe njerëzit e tjerë të prekshëm më të prekur nga epidemia e HIV-it dhe Tuberkulozit).

2. Për të siguruar përgjigje të qëndrueshme ndaj HIV përmes forcimit të koordinimit, udhëheqjes dhe angazhimit financiar dhe politik të Qeverisë; dhe

3. Për forcimin e shëndetit dhe sistemet e komunitetit që mundësojnë ndërhyrje të parandaluara bazuar në nevoja, të bazuara në prova dhe me kosto efektive për popullatat kryesore që preken më shumë nga HIV dhe Tuberkulozi.

3. Grupet e synuara/Përfituesit:

- Persona që injektojnë drogë;
- Punonjësit e seksit dhe partnerët e tyre seksualë;
- Meshkuj që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM),
- Personat që jetojnë me HIV/SIDA;
- Personat e burgosur;
- Gratë shtatzëna;
- Pacientët me TB dhe MDR-TB;

B. KUADRI I PËRFORMANCËS

Ju lutem shihni bashkëlidhur.

C. BUXHETI PËRMBLEDHËS

Ju lutem shihni bashkëlidhur.

VENDIM

Nr.220, datë 12.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË TATIMPAGUESVE DHE TË KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË THJESHTËZUAR TË FISKALIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 1, dhe 27, pika 1, të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura për transaksione me para në dorë, sipas nenit 22, të

ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, mund të lëshojnë fatura dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, nëse përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;

b) Nuk kanë asnjë shkelje të konstatuar në lidhje me moslëshimin e faturës në 3 vitet e fundit;

c) Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Tatimpaguesit që nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, të cilët lëshojnë fatura elektronike për transaksione pa para në dorë, sipas nenit 27, të ligjit nr.87/2019, mund të lëshojnë fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, nëse përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Nuk kanë asnjë shkelje të konstatuar në lidhje me moslëshimin e faturës në 3 vitet e fundit;

b) Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

3. Tatimpaguesi që lëshon fatura sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, mund të përdorë platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, për sa kohë që përmbush të gjitha kriteret e kërkuara. Në momentin kur një nga kriteret nuk përmbushet më prej tatimpaguesit, tatimpaguesi nuk mund të përdorë më tej platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, por duhet të zbatojë procedurën e fiskalizimit me anë të zgjidhjeve software-ike të certifikuara, sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr.87/2019.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet e përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr.221, datë 12.3.2020

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin në detyrë të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, si më poshtë vijon:

- Z. Dritan Gjonbalaj, kryetar;
- Znj. Elira Kokona, anëtar;
- Znj. Arta Gurabardhi, anëtar;
- Znj. Evis Mamaj, anëtar;
- Z. Artan Shkreli, anëtar.

2. Vendimi nr.752, datë 13.12.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 38, datë 27.2.2020

MBI MIRATIMIN E
“METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT
TË TARIFËS SË SHITJES SË GAZIT
NATYROR NGA FURNIZUESI I
MUNDËSISË SË FUNDIT”

Në mbështetje të nenit 13 dhe 90, pika 11, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 Për Sektorin e Energjisë elektrike, i ndryshuar, nenit 19 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.02.2020,

mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE, me nr.30/4 prot, datë 18.02.2020 “Për miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

Konstatoi se:

- Me vendimin nr. 186 datë 25.11.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur, “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e Draft – “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

-Në vijim të kësaj vendimmarrje u bënë publikimet në faqen e web-it të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE nr.32/58 prot datë 06.12.2019 si dhe botimi në Fletoren Zyrtare me nr.171 datë 16.12.2019.

-Për të marrë opinionet e palëve të interesuara referuar vendimit të Bordi i ERE-s, me nr. 186, datë 25.11.2019, ERE me anë të shkresës nr. 806 Prot., datë 10.12.2019 i'u drejtua, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK); Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë; Shoqatës së Konsumatorit; Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit; Konsumatori në Fokus; Alb gaz sh.a; Anio Oil & Gaz sh.p.k; Phoneix Petroleum sh.a; C.G.C sh.p.k; Balk gaz sh.p.k dhe Tap Ag Albania sh.p.k.

-Në përfundim të afateve me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve në lidhje me draft-metodologjinë e përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit, rezultoi se vetëm shoqëria Alb gaz sh.a me shkresën nr. 14 Prot., datë 08.01.2020 ka shprehur dakortësinë e saj.

-Nuk rezultoi të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palë interesit në lidhje me përmbajtjen e draftit të metodologjisë me të cilin bordi i ERE ka filluar procedurën.

-Drafti i Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit është përmirësuar përsa i përket formës, dhe përcjell në mënyrë të plotë e të qartë frymën e legjislacionit në fuqi për sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,



VENDOSI:

1. Miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”. (Bashkëlidhur)

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo metodologji hartohet në zbatim të nenit 90, pika 11 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, dhe në përputhje me nenin 20, të Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i tarifës së shitjes të gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente.

Neni 3
Zbatimi

Kjo metodologji do të zbatohet për të licencuarin e ngarkuar për shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e gazit natyror, i caktuar në përputhje me përcaktimet e nenit 90 dhe 91 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror” i ndryshuar.

Neni 4
Përkufizime

Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë Metodologji do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. **Ligji për Sektorin e Gazit Natyror** do të thotë Ligji nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”, i ndryshuar.
2. **ERE** do të thotë autoriteti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar.
3. **Licencë** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar.
4. **Furnizues i mundësisë së Fundit (FMF)** është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e



këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

5. **Tarifa e furnizimit të mundësisë së fundit** - do të thotë çmimi me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit shet tek klienti fundorë me qëllim sigurimin e gazit natyror si furnizues i mundësisë së fundit, duke reflektuar kostot e tij.
6. **Kosto direkte të furnizimit me pakicë** - do të thotë kosto administrative (që nuk lidhen me gazin natyror) por që lidhen me kryerjen e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
7. **Procedurë** - do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.
8. **Çdo shprehje apo term** tjetër i përdorur në këtë metodologji, do të ketë kuptimin e parashikuar në Ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar .

PJESA E DYTË PÛRCAKTIMI I TARIFËS SË SHITJES TË GAZIT NATYROR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 5

Metodologjia për përcaktimin e tarifës të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Tarifa për klientet fundorë të gazit natyror që furnizohen në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit do të përcaktohet bazuar në nivelin e presionit ku ata furnizohen.
2. Në përcaktimin e tarifës të furnizuesit të mundësisë së fundit do të përfshihen kostot në lidhje me blerjen e gazit natyror, kostot e përdorimit të rrjetit të transmetimit/shpërndarjes, kostot e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit si dhe marzhi i fitimit i cili vendoset nga Rregullatori dhe nuk duhet të jetë më i madh se 3% i totalit të kostove të blerjes së gazit natyror për qëllime të furnizimit si FMF.
3. Korrigjimi i koston direkte do të bëhet sipas parimit ex-post.
4. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera fuqi.
5. Marzhi i fitimit do të jetë një përqindje fikse e aplikuar mbi koston e blerjes së gazit natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit 5 të kësaj metodologjie, e cila duhet t’i kthehet furnizuesit si një kthim i arsyeshëm në mënyrë që të kompensojë riskun e tij të furnizimit.
6. Marzhi me pakicë nuk duhet të kalojë normën prej 3% të kostot së blerjes së gazit natyror.
7. Klientët e gazit natyror të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të paguajnë tarifën e furnizimit si dhe të gjitha tarifat përkatëse të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes në përputhje me nivelin e presionit ku klienti furnizohet.

8. Kostot për blerjen e gazit natyror për qëllime të furnizimit të kësaj kategorie klientësh, do të pasqyrohen në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit, e cila do të monitorohet nga ERE në mënyrë periodike. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të dërgojë në ERE çdo muaj evidencë të qartë në formën e një bilanci i cili të argumentojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e furnizuar nga FMF.
9. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të kërkojë nga klientët që të depozitojnë një garanci bankare të barabartë me vlerën financiare të furnizimit të pritshëm, vlerë kjo e dakortësuar në marrëveshjen mes palëve, e cila do të çlirohet menjëherë me likuidimin e detyrimeve financiare mes palëve.

Neni 6

Aplikimi nga FMF për përcaktimin e tarifës të furnizimit të klientëve të gazit natyror

1. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës të furnizimit, do të paraqesë në ERE aplikimin për përcaktimin e tarifës për shitjen e gazit natyror për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit. Ky aplikim do të përfshijë të gjitha kostot e identifikuara nga Furnizuesi sipas nenit 5 të kësaj metodologjie.
2. Deri në përcaktimin e tarifës nga ERE, Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të faturojë klientin e furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, me çmimin mesatar të ponderuar të gazit natyror të blerë për periudhën në të cilën furnizohet, të publikuar nga FMF, duke pasqyruar kostot administrative, të transmetimit/shpërndarjes, sipas nivelit të presionit ku është i lidhur klienti si dhe kostot e përcaktuara në nenin 5.
3. ERE në çdo rast do të vendosë tarifën e shitjes së gazit natyror për furnizuesin e mundësisë së fundit jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga paraqitja e aplikimit. Brenda kësaj periudhe ERE mund të vendosë për zhvillimin e seancave dëgjimore nëse gjatë aplikimit konstaton nevojën për sqarime.
4. Jo më vonë se 5 ditë nga vendimi i ERE-s, për miratimin e çmimit të shitjes nga FMF, nëse konstatohet diferencë midis çmimit të miratuar dhe atij të përcaktuar sipas pikës 2, të këtij neni, nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të lëshohet një faturë me të gjithë kompensimet për diferencat ndërmjet çmimit të faturuar sipas pikës 2 të këtij neni dhe çmimit të përcaktuar nga ERE.

Neni 7

Llogaritja e Tarifës të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. CBEt është çmimi mesatar i ponderuar për sasinë e gazit natyror të blerë nga tregu i parregulluar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit.

$$CFMF_t = CBG_t + Pr * CBG_t + TRrTSH_t + CA$$

Ku: $CFMF_t$ Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t



<i>CBGn</i>	<i>Është çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së gazit natyror për periudhën e furnizimit nga Tregu i parregulluar</i>
<i>Pr</i>	<i>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (do të pranohet në masën 3% për dy vitet e para e më tej do të rishikohet bazuar në të dhënat historike)</i>
<i>TRrTSHt</i>	<i>Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t</i>
<i>CA</i>	<i>Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit</i>

2. Tarifat e furnizimit të gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të jenë më të larta se çmimi i furnizimit të klientëve të ngjashëm që furnizohen në treg. Gazi natyror i kontraktuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të sigurohet mbi bazën e një procedure konkurruese dhe me çmimin e ofertës më të ulët në treg. Në rastin kur ekziston vetëm një ofertë, si furnizues i mundësisë së fundit, në këto kushte ERE do e bazojë vendosjen e çmimit sipas metodës krahasimore, referuar furnizuesve të ngjashëm në vendet fqinje.
3. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të faturojë gazin natyror në Pik, për konsumin në bazë të konsumit për orët e pikut, sipas fashës orare të përcaktuar.

Neni 8

Të drejta dhe detyrime të tjera

1. Tarifa e llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj metodologjie nuk përfshin detyrimet e tjera tatimore të cilat furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar t'i identifikojë në një zë veçantë në faturën e shitjes së gazit natyror për klientin fundor të furnizuar prej tij, nëse ka.
2. “Furnizuesi i mundësisë së fundit mund të kërkojë ndërprerjen e përkohshme të furnizimit, për shkak të detyrimeve të papaguara nga klienti fundor, duke dorëzuar një kërkesë te operatori i sistemit përgjegjës.”



3. FMF ka detyrimin të blejë gaz natyror me shumicë në emër të klienteve të gazit natyror të furnizuar prej tij dhe të jetë përgjegjës për balancimin e diferencës për një furnizim të tillë me shumicë.
4. FMF ka detyrimin e informimit të klientëve të gazit natyror për kushtet e shërbimeve të ofruara prej tij.
5. FMF ka detyrimin që brenda 8 ditëve nga fillimi i furnizimit t'i vërë në dispozicion klientit të gazit natyror që do të furnizohet prej tij, një kontratë furnizimi.
6. FMF duhet të furnizojë klientet e gazit natyror që furnizohen prej tij, për një periudhë jo më të gjatë se afati i parashikuar në Ligjin nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe t'i ndihmojë që të gjejnë një furnizues alternativ brenda këtij afati.

Neni 9

Monitorimi i tarifës të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të dorëzojë dhe të argumentojë në ERE, për çdo muaj, të gjitha kostot, bazuar në elementët e këtij çmimi, siç përcaktuar në nenin 6 të kësaj metodologjie.
2. FMF duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e klientëve të gazit natyror sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, dhe çdo aktivitet tjetër tregëtar që ushtron. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të ERE-s sa herë që kërkohen prej saj.
3. ERE do të monitorojë dhe kontrollojë përcaktimin e tarifës të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Neni 10

Publikimi

1. I licencuari i ngarkuar me detyrimin e shërbimit si FMF, duhet të mirëmbajë dhe të publikojë në faqen e internetit, informacione rreth shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit, tarifën e furnizimit për muajt paraardhës për kategori të ndryshme të klienteve dhe parashikimin për tarifën që mund të aplikohen në muajin pasardhës për klientet e gazit natyror që do të furnizohen nga ky furnizues.
2. Furnizuesi i mundësisë së fundit përgatit dhe publikon, të paktën një herë në vit, raportin, i cili përmban numrin e klientëve fundorë të furnizuar, sasinë e përgjithshme të gazit natyror të furnizuar dhe kohëzgjatjen mesatare të furnizimit të mundësisë së fundit. Ky raport duhet të vihet në dispozicion të ministrisë, ERE-s dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.



PJESA E TRETË DISPOZITA KALIMTARE

Neni 11 Interpretimi

Në rast se, një çështje nuk është trajtuar në këtë Metodologji, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.

Neni 12 Amendime të rregullores

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të ERE, si dhe në përputhje me Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Neni 13 Hyrja në fuqi

Kjo Metodologji u miratua me vendimin e Bordit të ERE nr _____ datë _____, hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË Nr. 2685, date 11.3.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit të ri elektrik 20 kV, Fideri F2 dhe Fideri F4, në Fushë Krujë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në

Republikën e Shqipërisë”, sipas tableës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëmbjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në OSHEE, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është në shumën 39 399.36 (tridhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
Kryetar i Komisionit të Posaçëm
të Shpronësimeve
Artan Shkreli



LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE PROJEKTTIT
"NDERTIMI I RRJETIT TE RI ELEKTRIK 20KV NE FUSHE KRUJEFIDERI F2 DHE FIDERI F4"

Qarku: Durrës; Bashkia Krujë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: "Tokë arë" dhe "truall"

Të dhëna për pronësinë									
Nr.	Numri i Kabinës	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. pronës m ²	Shp. shpronësimi m ² për kabinën
FSHATI ARRAMERAS ZONA KADASTRALE 1042									
	F2/02	Shtet			1042	185	Kanal	900	9.24
	F2/02	Afrim		Vathi	1042	187/70	Are	6240	9.24
	F2/03	Shtet			1042	186	Kanal	900	9.24
	F2/04	Shtet			1042	230	Kanal	22000	9.24
	F2/05	Shtet			1042	231	Ruge	500	9.24
	F2/05	Osman		Cela	1042	46/25	Are	1490	9.24
	F2/06	Shtet			1042	229	Kanal	7600	9.24
	F2/07	epronaret Stafuka			1042	48/49	Are	9835	9.24
FSHATI LARUSHK ZONA KADASTRALE 2385									
	F2/09				2385	229			9.24
	F2/10	Selman		Caca	2385	76/5	Truall	200	9.24
	F2/12	Shtet			2385	182	Rr+Kanal	35000	9.24
	F2/11	Shtet			2385	182	Rr+Kanal	35000	9.24
	F2/13	Shtet			2385	183	Rr+Kanal	1600	9.24
	F2/14				2385	30/28			9.24
	F2/14				2385	238			9.24
	F2/15	Shtet			2385	205	Rr+Kanal	1500	9.24
	F2/08				2385	226			9.24
FSHATI HALIL ZONA KADASTRALE 1921									
	F4/01	Muharrem		Selimi	1921	22/7	Take bujqesore e zene me pemë frutore(nuk preken dru frutore)	1500	9.24
	F4/02	Shtet			1921	171	Rr+Kanal	18700	9.24
	F4/03	hkepronaret		Halili	1921	26/12	Are	539	9.24
	F4/04	Shtet			1921	193	Ruge	1000	9.24
	F4/05	Shtet			1921	354	Truall	9000	9.24
	F4/05	Shtet			1921	126/44	Are	1331	9.24
	F4/06	Kujtim	Sefer	Seferi	1921	120/10	Are	3400	9.24
	F4/07	Shtet			1921	349	Pyll	31900	9.24
	F4/09	Shtet			1921	31/17	Kullote	2500	9.24
	F4/10	Shtet			1921	171	Rr+Kanal	18700	9.24
	F4/11	Shtet			1921	184	Ruge	400	9.24
	F4/11				1921	214/73			9.24
FSHATI ARRAMENAS ZONA KADASTRALE 1042									
	F4/01								
	F4/02								
	F4/03								
	F4/04								
	F4/05								
	F4/06								
	F4/07								
	F4/09								
	F4/10								
	F4/11								



F4/12	Shtet			1042	285	Kanal	3800	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/13	Shtet			1042	286	Kanal	3000	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/13	Rexhep		Hithi	1042	299/6	Are	13370	9.24	318	2938.32	Konfirmuar ZVRPP
F4/15	Shtet			1042	320	Kullote	13500	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/16	Sami		Haki	1042	364/18	Are	1700	9.24	318	2938.32	Konfirmuar ZVRPP
F4/17	Shtet			1042	196	Perrua	400	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/17	Dashamir		Cela	1042	138/1	Are	4000	9.24	318	2938.32	Konfirmuar ZVRPP
F4/19	Shtet			1042	398	Ruge	5500	9.24			Konfirmuar ZVRPP
FSHATI LARUSHK ZONA KADASTRALE 2385											
F4/21	Shtet			2385	204	Rr+Kanal	6700	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/22				2385	390						Nuk ka informacion nga ZVRPP
				2385	226						Nuk ka informacion nga ZVRPP
FSHATI ZEZE ZONA KADASTRALE 3908											
F4/23				3908	219			9.24			Nuk ka informacion nga ZVRPP
F4/23	Xhavit	Shaban	Kurti	3908	49/12	Are	2800	9.24	163	1506.12	Konfirmuar ZVRPP
F4/26				3908	216			9.24			Nuk ka informacion nga ZVRPP
F4/24	Hasan	Muharrem	Stafuka	3908	42/7	Are	11500	9.24	163	1506.12	Konfirmuar ZVRPP
F4/25				3908	217			9.24			Nuk ka informacion nga ZVRPP
	Rahman		Raja	3908	42/26	Are	3000	9.24	163	1506.12	Konfirmuar ZVRPP
FSHATI NIKEL ZONA KADASTRALE 2795											
F4/27	Shyqyri	Petrit	Xhametaj	2795	34/14	Are	2100	9.24	163	1506.12	Konfirmuar ZVRPP
F4/27	Shtet			2795	35/45	Ruge	600	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/28	Shtet			2795	131/75	Truall	3600	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/29	Servet		Çangu	2795	97/44	Are	2555	9.24	163	1506.12	Konfirmuar ZVRPP
F4/30	Komuna	Nikel		2795	191	Truall	10000	9.24			Konfirmuar ZVRPP
F4/32	Bajram		Brama	2795	184/1	Are	2300	9.24	163	1506.12	Konfirmuar nga ZVRPP, ne seksionin E te karteles se pasurise ka shenimin "Ne favor te Raifeisen Bank sh.a.
Vlera paraprake e shpronësimit									147.84		39,399.36

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë